

**UDHËZIM**  
**Nr. 34, datë 21.1.2013**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 22, DATË 24.9.2012 “PËR  
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR RUAJTJEN E SIGURISË SË TË DHËNAVE  
PERSONALE TË PËRPUNUARA NGA KONTROLLUESIT E VEGJËL”**

Në mbështetje të shkronjës “f” pika 1 e nenit 31 dhe në bazë të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr. 22, datë 24.9.2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga kontrolluesit e vegjël”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Në titullin e udhëzimit, togfjalëshi “kontrolluesit e vegjël” zëvendësohet me “subjektet përpunuese të vogla”.

2. Në pikën 1, togfjalëshi “teknike dhe organizative” zëvendësohet me “teknike, organizative edhe në lidhje me personelin”.

3. Përmbajtja e pikës 2, ndryshohet si vijon:

“Subjekte përpunuese të vogla janë kontrolluesit ose përpunuesit, të cilët përpunojnë të dhëna personale në mënyrë elektronike ose manuale, duke shfrytëzuar më pak se 6 persona për të kryer përpunimin, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose me anë të përpunuesve”.

4. Në pikën 4, akti nënligjor i referuar “Udhëzimin nr. 2, datë 25.2.2010 “Për detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale”, zëvendësohet me “Udhëzimin nr. 24, datë 27.12.2012 “Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale””.

5. Në pikën 5, togfjalëshi “teknike dhe organizative” zëvendësohet me “teknike, organizative edhe në lidhje me personelin”.

6. Në pikën 6, pas fjalës “organizative” shtohet togfjalëshi “edhe në lidhje me personelin”.

7. Përmbajtja e paragrafit 2 të shkronjës “a” të pikës 8, ndryshohet si vijon:

“Analiza e riskut kryhet në mënyrë periodike dhe dokumentohet në mënyrë të kuptueshme për praktikën e veprimtarisë së subjekteve përpunuese”.

8. Në pikën 9, data e udhëzimit 21 ndryshohet në “24.9.2012”.

Ky udhëzim hyn në fuqi në të njëjtën kohë me udhëzimin nr. 22, datë 24.9.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONERE**  
**Flora Çabej (Pogaçe)**